



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Lenda : Kontabiliteti Financiar
Departamenti : Kontabilitet dhe Financa

Msc. Valdrin Misiri

Pejë, Prill 2017

Kontabiliteti Financiar

- Viti II-të, Semestri IV
- Departamenti : KF
- Statusi i lëndes : Obligative
- Javët mësimore: 15 [4 orë ligjerata, 8 orë ushtrime(4 grupe)]
- Mësimdhënëse: MSc. Fidane Spahija
- Asistent: MSc.Valdrin Misiri
- Orari i ushtrimeve: E hene (G3 – ora 09:20 - 10:40 C2)
- (G4 – ora 10:40 - 12:00 C2)
- Orari i ushtrimeve: E Enjte (G2 – ora 13:20 - 14:40 C2)
- (G1 – ora 14:40 - 16:00 C2)

- E-maili: valdrin.misiri@unhz.eu
- Website: www.unhz.weebly.com

Llojet e të arkëtueshmeve

- Në praktiken e bizneseve bashkëkohore njihen tri lloje të arkëtueshmeve:
 1. Llogaritë e arkëtueshme (accounts receivable)
 2. Dëftesat e arkëtueshme (note receivable)
 3. Të arkëtueshmet tjera
- Llogaritë e arkëtueshme janë të drejtat për shumat e borxhit ndaj firmave blerëse dhe individëve, të krijuara nga shitjet e mallrave dhe shërbimeve me afat pagese (kredit)
- Dëftesat e arkëtueshme janë instrumente monetare kreditore...
- Të arkëtueshmet tjera nuk rezultojnë nga transaksionet normale të biznesit, sic janë p.sh. shitjet e mallrave dhe shërbimeve.

Kontabiliteti i borxheve të këqija

- Shitja e mallrave dhe shërbimeve me afat pagese është bërë vecori kryesor në transaksionet tregtare të bizneseve.
- Kjo formë e shitjes sjell dobi të madhe
- Në anën tjetër këto benefite, të krijuara nga shitjet e mallrave me afat pagese njëkohësisht, përcillen edhe kosto sepse disa nga blerësit nuk paguajnë në afatin e pagesës, dhe në disa raste nuk paguajnë fare

Kontabiliteti i borxheve të këqija

- Pamundësia e mbledhjes së arkëttimeve nga disa blerës, firmës shitëse i krijon shpenzime të cilat emërtohen shpenzime të pambledhshme (shpenzime të borxheve të këqija ose shpenzime të llogarive të dyshimta)
- Evidenca kontabël e shpenzimeve të borxheve të këqija bëhet nëpërmjet dy metodave:
 1. Metoda e uljeve
 2. Metoda e shlyrjes direkte

Metoda e uljeve

- Në krahasim me metodën e shlyrjes direkte, metoda e uljeve përdoret më shumë në praktikë, për faktin se është në pajtushmeri me parimin e shkaksisë.
- Sipas këtij parimi në llogaritjen e fitimit të periudhës duhet kundërvënë të hyrat me shpenzimet të cilat janë krijuar nga gjenerimi i këtyre të hyrave.

Vlerësimi i llogarive të dyshimta

- Shembull:
- Supozojmë se firma “XYZ” gjatë vitit 2015 ka pasur shitje me afat pagese në vlerë prej 300.000 € nga të cilat në fund të vitit është vlerësuar se 42.000 € janë të pambledhshme.
- Departamenti i shitjes ka vlerësuar se 8.000 € nga shitjet e këtij viti janë llogari të dyshimta dhe se ky vlerësim është bazuar në përvojën e shitjeve nga vitet 2013 dhe 2014.
- Më datën 31.12.2015 bëni veprimet rregulluese në lidhje me llogaritë e dyshimta të vlerësuara nga “XYZ”

Shlyerjet e llogarive të dyshimta

- Për arkëtimin e llogarive të dyshimta, firmat përdorin mënyra dhe instrumente të ndryshme dhe në disa raste edhe mekanizma ligjorë.
- Në momentin kur menaxhmenti i kompanisë konsideron se janë shterur të gjitha mundësitë për arkëtimin e llogarive të dyshimta, ai merr vendim dhe autorizon kontabilistin që të bëjë shlyerjen e tyre.
- Në këtë rast shuma e shlyerjeve regjistrohet ne debi të llogarisë “ulje për llogaritë e dyshimta” dhe për të njejtën shumë krediton “LL/A”

Shembull – Shlyerjet e llogarive te dyshimta

- Supozojmë se me 09.01.2015 menaxheri i firmes “XYZ” ka vlerësuar se bleresi N nuk ka mundësi ta paguajë borxhin sepse ai ka falimentuar, prandaj autorizon kontabilistin të shlyejë borxhin e tij në vlerë prej 4.500 €.

Arkëtimet e llogarive të dyshimta të shlyra më parë

- Në praktikë ndodhin edhe situata kur firmat arkëtojnë tërësisht ose pjesërisht një pjesë të shumës së borxheve të këqija, të cilat janë shlyer më parë.
- Arkëtimet e borxheve të këqija, të shlyra më parë, kërkojnë të bëhen dy regjistrime kontabël
- Në regjistrimin e parë debiton LL/A dhe krediton llogaria, uljet për llogaritë e dyshimta.
- Në regjistrimin e dytë, për shumën e arkëtuar, debiton llogaria e keshit dhe krediton LL/A

Shembull – Arketimet e llogarive te dyshimta te shlyra me pare

- Supozojme se me 28.01.2016 “XYZ” ka arkëtuar në kesh 5.200 €, në emër të borxheve të këqija të shlyera ne vitin 2015.

Qasjet për borxhet e këqija në metodën e uljeve

- Për vlerësimin e borxheve të këqija brenda metodës së uljeve(indirekte) perdoren dy qasje:
 1. Përqindjet në shitjet neto
 2. Përqindjet në llogatitë e arkëtueshme
- Me metodën e përqindjeve në shitjet neto, shpenzimet e borxheve të këqija vlerësohen mbi bazen e aplikimit të përqindjes në shitjet neto me afat pagese gjatë periudhës.
- Përqindja vendoset mbi bazën e përvojes së kaluar dhe natyrisht edhe prej politikës së firmes ndaj shitjeve me kredi.

Shembull

- Supozojmë se me 31.12.2016 menaxhmenti i “X” ka marrë vendim që bazë e përqindjes së borxheve të këqija në shitjet neto të këtij viti të merret 1.2%. Shitjet neto gjatë vitit 2016 janë 700.000 €.
- Le të supozojmë se me 31.12.2016 përpara veprimeve rregulluese në librin kryesor llogaritë në vijim kanë këtë gjendje:
 1. “LL/A” debitojnë për vlerën 285.000 €, ndersa
 2. “Ulje për llogarite e dyshimta” krediton për 4.000 €

Përqindjet ndaj LL/A

- Disa firma në vlerësimin e borxheve të këqija e përdorin qasjen e përqindjes në gjendjen e llogarive të arkëtueshme.
- Meqenëse qasja në fjalë i mat borxhet e këqija nga prizmi i pasurisë, ndryshe emërtohet edhe qasje e bilancit të gjendjes.
- Gjithashtu, ky variant pikënisje në vlerësimin e llogarive të dyshimta e ka përvojën e kaluar me borxhet e këqija.

Shembull

- Supozojmë se “X” gjatë 5 viteve të kaluara ka pasur këtë situatë lidhur me llogaritë e arkëtueshme dhe borxhet e këqija si në vijim:

Viti	Gjendja e LL/A-ve	Borxhet e këqija
2010	230.000	4.350
2011	280.000	4.800
2012	355.000	5.500
2013	485.000	5.150
2014	350.000	5.900
	1.700.000	25.700

- Supozojmë se me 31.12.2016 gjendja e llogarive të arkëtueshme është 380.000 € kurse ulje për llogaritë e dyshimta ka një gjendje kreditore në vlerë prej 4.500 €.

KONTABILITETI I QIRASE

Roli i qirase si burim i financimit

- Furnizimin me pasuri firma mund ta beje ne menyra te ndryshme.
- Perveç blerjes ne para te gatshme apo forma te tjera me afat pagese, si menyre apo alternative tjeter e furnizimit me pasuri firmat e perdorin edhe qirane.
- Pronari i pasurise se dhene me qira eshte qiradhenesi (lessor), ndersa kerkuesi i perdorimit te sherbimeve te pasurise se marre me qira eshte qiramarresi (lessee).

Roli i qirase si burim i financimit

- Marreveshja e bere me kontrate, ndermjet qiradhenesit dhe qiramarresit sipas, se ciles qiradhenesi transferon te drejten e shfrytezimit te pasurise se tij tek qiramarresi, per nje periudhe te caktuar kohore dhe si kundervlere per kete kerkohet qe qiradhenesit ti paguhet shuma e caktuar e parave gjate periudhes se perdorimit te pasurise se tij emerohet si qira (leasing)
- Ekzistojne dy forma themelore te qirase:
 1. Qiraja operative
 2. Qiraja kapitale

Qiraja operative

- Ne qofte se me kontrate qiradhenesi e transferon te drejten e shfrytezimit te pasurise se tij te qiramarresi, per nje periudhe kohore te caktuar, kurse nga ana tjeter ai mban pergjithesine per shpenzimet e mirembajtjes, sigurise, rrezikut, tatimit etj... atehere ne kete rast nje kontrate e tille emerohet si **qira operative**.
- Per dallim nga qiraja operative, **qiraja kapitale** eshte me afat te gjate dhe jo e anulueshme. Nen kushtet e **qirase kapitale**, qiradhenesi krahas se drejtes se shfrytezimit te pasurise se qiradhenesit, njekohesisht bart pergjegjesine per te gjitha shpenzimet e pasurise se marre me qira

Qiraja operative

- Tek ky lloj i qirase, qiramarresi ne harmoni me kontraten eshte i obliguar te paguaje rregullisht qirane, ndryshe kur ajo nuk paguhet ne daten e skadimit te afatit, qiramarresi eshte i detyruar te paguaje kamate ndeshkuese.
- Periudha e qirase operative eshte me e shkurter se 5 vjet.
- Po ashtu tek ky lloj i qirase shumat e paguara jane me te uleta se kostoja e pasurise se marre me qira.
- Qiraja operative eshte e pershtatshme kur firma ka nevojte per pasuri fikse ne nje periudhe afatshkurter.

Qiraja operative

- Kontabiliteti i qirase operative, nga prizmi i qiradhenesit me rastin e pageses se qirase, trajtohet si shpenzim ndersa, tek qiradhenesi me rastin e arketimit te qirase ajo trajtohet si e hyre nga qiraja.
- Ne bilancin e qiramarresit, ne transaksionin e qirase operative, nuk paraqitet pasuria e marre me qira si kategori e pasurise. Ndersa ne strukturen e detyrimeve qiraja operative, e llogaritur ne fund te periudhes mund te prezentohet si detyrim afatshkurter.

Shembull

- Supozojme se firma “X” me 01.02.2016 per nevojat e kryerjes se disa sherbimeve te klienteve te saj, ka marre me qira nje automjet transportues nga firma “Y” me seli ne Peje . Afati i kontrates se qirase eshte 12 muaj dhe firma “X” eshte e obliguar qe ta paguaje qirane mujore ne kesh ne vlere prej 1.200 €, ne fillim te cdo muaji.
- Beni evidencen kontabel ne rastin e qiramarresit dhe ne rastin e qiradhenesit.

Pyetje



Suksese!